

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# NACIONAL


Drejtör:  
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

## Ted Kenedi, senatori i pëjetshëm i Amerikës

Senatori Ted Kenedi, njëri prej senatorëve më të fuqishëm në historinë e Amerikës, dhe njëri prej tre vëllezërve ku triumfet e politikës ...

faqe 5




## Kafenë në Prishtinë, drekën në Durrës, darkën në Dhërmi

Muri shqiptaro-shqiptar u bë copë-copë me hapjen e tunelit të Kalimashit. Shqiptarët nuk i kanë pengesë kufijtë.

Reportazh nga Gani Mehmetaj

faqe 2



## DREJT BASHKIMIT KOMBËTAR

Nga Mujë BUÇPAPAJ

Shqipëria nuk mban përgjegjësi për ndryshimin e kufijve në Ballkan, por nëse një proces i tillë fillon...

faqe 19

## KOLONIZIMI I KOSOVËS ME SERB

Nga Dr. Branko Horvat

Nuk ka qenë vetëm qeveria serbe ajo që ka përgatitur plane për shpërnguljen e shqiptarëve, por edhe intelektualët serbë. Janë shkruar disa referate...

faqe 11

## ARSYET E VONESËS SË SHQIPTARËVE

Nga Prof. Dr. Rexhep Krasniqi

Në gjurmimet t'ona për të gjetë arsytë e vonesës rreth zgjimit e depertimit të idesë komtare të shqiptarëve, na duhet me pasë parasyshë faktin e pamohushëm se

faqe 10

## SHQIPËRIA JO MË E NDARË NË 5 SHTETE

Nga Musa Tartari

Bashkimi i kombit të coptuar është i pashmangshëm. Po kur nis coptimi i kombit shqiptar dhe pse po vazhdon edhe sot?

faqe 3

## KOSOVA KA MBËSHTETJEN E SHBA

Nga Kristofer Dell

Republika e Kosovës mund të llogarisë në mbështetjen e vazhdueshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës...

faqe 4

## SFIDAT E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Nga Prof. Mujë Rugova

Mujë Rugova është i lindur në Haxhaj të Rugovës së Pejës, ku edhe i ka kryer mësimet e fillores...

faqe 4

Shkëlqimi i përhershëm i artistes shqiptare

# Ema Andrea, famë e merituar

faqe 12



## Në BRENDËSI

### Gënjeshtra partie

Tregim nga Ramiz Gjini

faqe 14

### Të ftohtit rreth zjarrit

Poezi nga Gary Snyder

faqe 16

### "Botë e qethur"

Tregim nga Zhuliana Jorgaxhi

faqe 15

### Mbi përkthimin e Kadaresë

Studim nga David Bellos

faqe 20

### Një ngjarje e veçantë

Tregim nga Mark Tuein

faqe 13

### Mëkatet e bardha

Poezi nga Valentina Dafa

faqe 17

### Poezia si kumt

Esse nga Lulzim Logu

faqe 21


### I vetmuar

Tregim nga Jona Kukeli

faqe 23

Poezi nga:  
Hektor Metani,  
Rrustem Gërguri,  
Ali M. Lajçi

faqe 17,22



Me aktorin e shquar Xhejms Belushi

faqe 9



Kënga e shpirtit mbi ujëra

Lirika nga J.W.Goethe

faqe 6-7


## I dua vajzat e kafaneve

Intervistë me kengëtarin e ri Mondri

faqe 23

# TË FTOHTIT RRETH ZJARRIT

Nga **GARY SNYDER**



Në foto : Gery Snyder

Gary Snyder u lind në San Francisco në vitin 1930. Deri tani ka botuar 17 libra me poezi dhe prozë. Ai ka fituar disa çmime letare si: *The American Academy of Arts and Letters award*, çmimin *Bollingen Prize*, çmimin *Guggenheim Foundation fellowship*, çmimin *Bess Hokin Prize*, çmimin *Levinson Prize*, çmimin *Robert Kirsch Lifetime Achievement Award* nga gazeta *Los Angeles Times*, si dhe çmimin *Shelley Memorial Award*. Snyder u zgjedh si konsultat i organizatës *The Academy of American Poets* në vitin 2003. Ai punon si profesor i Anglishtes në Universitetin e Kalifornisë, në Davis.

të harruar tek rrezohet  
poshtë e gjitha.

Një lule  
për asgjë;  
një ofertë;  
pa marrës;

flokë dëbore, feldspat, baltë.

## TE PËRROI I PIUTËS

Një pishë e zezë  
Një pemë, do të mjaftonte  
Ose madje një gur, një grykëz e vogël,  
Një barkë e përbashkët në një pishinë.  
Kodër pas kodre, të palosura dhe të përdredhura,  
Pemë hijerënda  
të dala nga plasa gurësh  
Hënë e madhe mbi to, është e tepërt.  
Shtegtarët e mendjes. Një milion  
Vera, pezull era e natës dhe shkrep  
Të ngrohtë. Qielli përmbi malet e pafundme.  
Të gjitha rraqet që shoqërojnë të qenarit human  
Pikojnë në ikje, shkëmbinjtë kryeneç luhaten  
Madje edhe e tanishmja e rëndë e koriti  
Këtë gurgullimë zemre.  
Fjalët dhe librat  
Si pisha të zeza në qetat e larta  
Humbasin në erën e thatë.

Një mendje e pastër, e vëmendshme  
Nuk ka tjetër domethënie përveç atë  
Që përpiqet të duket  
plotësisht.  
Askush nuk dashuron shkëmbinj, ja që jemi këtu.  
Të dridhura nate. Një fishkëllimë  
Nëpër dritën e hënës  
Rrëshqet në hijet e Jupiterit:  
Atje fshehur  
Sy të ftohtë krenar  
Kuguarësh ose ujqish  
Më shikojnë tek ulem dhe ngjitem.

## RIVIERA E PISHAVE

Nga maja  
e kështjellës Matsue  
milje të tëra me fusha orizi  
kodra dhe një liqe i gjatë.  
një fëmijë shkollë ka krijuar një teleskop  
dhe shikon përmbi qytet.

xhuxh i dyqaneve të raja  
kjo kështjellë majë kodre  
zhytje delfinësh në  
çati si brirë—  
askush tani nuk e di me  
tamam se si i ngjiten  
gurët e latuar gjigande.


familja Matsudaira  
e pati të tërën të tyre,  
qëndrojë duke vështruar  
në këtë gjilpërë ere  
në dimër: të gjitha  
fshatrat e tyre të vogla  
nën dëborë.

## VIJAT NË TRUPIN E KRAPIT

peshku i majm e i vjetër i jetës së pasosur  
në gropëza të turbullta tretur anës lumit  
gojën e rrumbullakët dhe të butë, baltë pohuese

nëpër kallame, përbri rrugës së trenit

nuk do i dëgjoi qarjet humane  
por pishat do të rriten në mes të këtyre ngushticave  
para se ta ktheni barun nga dielli.



## RRUDHAT E BALLIT

Tehu i kancerit  
Ajet kundra tatëpjetës—ne ndjejmë  
një fresk të plotë  
Që mbytet prapë poshtë.  
Këtu drerët e dimrit  
Një sharrë me zinxhirë në hungërimë.

Dhjetë ditë të lagështa dhe kamioni ndalon,  
Pemët marrin frymë.  
Të dielën xhipsi me 4-rrrota shtypte i kompanisë  
Reality  
Sjellë tokë-blerës, shikues, që i  
Thonë tokës  
Hapi këmbët.

Aeroplanët pëlcastin tinguj mbi krye, është mirë  
këtu;  
Çdo puls i kalbur në zemër  
Në venat e sëmura nga majmëria e Amerikës  
E shtynë tehun më afër—

Një buldozer grinë dhëmbët e përjarget  
Duke rrëshqitur e gogësitur në majë  
Të majave të qëruara të shkurreve  
Në lutje për një burrë  
Nga fshati.

Matanë është një pyll që të çon tek Arktiku  
Dhe një shkretëtirë që është akoma e Piutëve  
Dhe këtu ne duhet të heqim  
Vijën tonë.

## PAGJË

heshtje  
e natyrës  
përbrenda.

fuqia e brendshme.  
fuqia

pa gjë.

shtegu mund të qesin kudo—jo  
përfundon në vetvete.

fundi është,  
mëshirë—lehtësi—

shërim,  
jo ruajtje.

duke kënduar  
provën

provën e fuqisë së brendshme.

## ÇFARË KAM MËSUAR

Çfarë kam mësuar përveç  
përdorimit të drejtë të disa veglave?

Momentet  
në mes të punëve me kënaqësi kryeneçe.  
Të rri i heshtur, të pi, verë,  
dhe të mendoj llojin tim  
të mendimeve me koje të thatë.

—lulet e para të livadheve  
dhe pranverën e të  
gjitha tokave.  
I shfaqti haptas:  
petalet e verdha, flokët e artë,  
të gjithësisë  
duke e parë heshtjen:  
kurrë dy herë njësoj,  
por kur e kryej mirë,

e kaloj tek të tjerët.

## TË FTOHTIT RRETH ZJARRIT

Pi kafe të zezë nga një termos  
ulur në një cung.

stivat e druve digjen, majat e  
shkurreve të brishta jeshile  
të marra the të përziera brenda  
Tek qendra: një grumbull hiri  
që shtrëngon të kuqen përbrenda.  
e shtynë nxehtësinë poshtë  
tek mbrojtësja e fytyrës  
me buzë të skuqura nga prushi;

Krasitja, hollimi, prerë si brushë  
me lëmashk nga insektet dhe myku—  
re barku bojë hiri  
lëkundën ngadalë e butë përmbi  
ndoshta shiun, sjellin fundin  
e kësaj thatësisë.

Furçat e djegura heqin nxehtësi  
nga zjarret e egra të verës që vjen  
dhe sjellin shiun në kohë,  
që zjarret ta pastrojnë rrëmujën.



rrëmujën e zemrës.  
Kafe të zezë, të hidhur, të nxehtë,  
tymi ngrihet shpejt dhe qetëson ajrin  
pezull dhe të ftohtë.

## Perktheu: Gjekë Marinaj

## SA PËR POETËT

Sa për poetët  
Poetët e tokës  
Që shkruajnë poezi të vogla,  
Nuk kanë nevojë për ndihmën e askujt.

Poetët e ajrit  
Luajnë me tufanet më të furishëm  
E nganjëherë kthehen në vorbull.  
Poezi pas poezie,  
Bëhen spirale e të njëjtës etje.

Në minus 50 grade (f)  
Vaji i makinerive nuk do ketë efekt  
Propana mbetet e mbyllur.  
Poetët e zjarrit  
Digjen në zeron absolute  
Dashuria e fosileve e ndritur lart.

Poeti i parë  
I ujit  
Qëndroi poshtë gjashtë vjet.  
Qe i mbuluar me zhumile deti.  
Jeta në poezinë e tij  
La miliona  
gjurmë të ndryshme  
të mbytura në baltë.

Me diellin dhe hënën  
E barkut të tij,  
Poeti kozmik  
Fle.  
Qielli nuk ka fund—  
por poezitë e tij,  
si pata të egra,  
fluturojnë nga tehu.

## PËR ASGJË

Toka një lule  
Një bimë në harkun  
e thellë të dritës  
kacavjerrë përmbi hapësirat  
e gjëra dhe të forta  
kristale vocërrake të dërmuara;  
kripëra.

Taka një lule  
buzë një gjiri ku një korb  
kthen përmbys nga një  
dritëz, një ngjyrë